



Prishtinë: 30.09.2011

Kodi i ZRRE-së: V_375_2011

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_633_08_11

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_633_08_11**;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 23.09.2011;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 30 shtator 2011 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Toskić Jeftimije (parashtruesi i ankesës Fadile Salihaj me shifër DPZ - 4916) nga Prizreni si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 11.11.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 04.11.2010 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 11.06.2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse te konsumatorit ku kanë konstatuar se gjatë kontrollimit kemi hasur në njehsor te dëmtuar, ku është xhami i njehsorit është i krisur hyn filmi, dhe është rekomanduar që njehsori të shkoj në kalibrim.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 000752 i datës 11.06.2007
- Me datë 15.11.2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë dal te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik me nr. 4218086 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 5165144.
Provë: Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorit elektrik i datës 15.11.2007
- Me datë 05.12.2007 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 4218086 ku është konstatuar se njehsori elektrik bllobat shtetërore i ka në rregull, për rreth qelqit nga ana e epërme është futur shiriti filmik ku është penguar puna e diskut, qelqi i thyer si dhe është prerë kufizuesi i qelqit.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 6 /5 i datës 05.12.2007
- Me datë 15.04.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut, për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse te konsumatorit ku kanë konstatuar gjendjen e njehsorit elektrik sipas procesverbalit të laboratorit të kalibrimit dhe kanë bërë regjistrimin e pajisjeve elektrike te konsumatorit.
Provë: Procesverbali i KEK-ut, nr. 0114461 i datës 15.04.2008



- Me datë 30.04.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPZ08HP04269 në vlerë prej 3,267.29 €.
Provë:Fatura DPZ08HP04269 e datës 30.04.2008
- Me datë 22.10.2010 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, duke theksuar se është vendosur në shtëpi të boshatisur te një Serbi Toskić Jeftemije, dhe pas vendosjes në atë shtëpi lexuesit e KEK-ut e kanë vizituar atë shtëpi dhe kanë pa gjendjen e njehsorit elektrik i cili ka pas xhamin e thyer. Ekipi i KEK-ut me ka thënë se duhet të bëj ndërrimin e njehsorit elektrik, mirëpo unë për shkak të kushteve shumë të vështira ekonomike dhe si përfitues i ndihmave sociale nuk kam pas mundësi ta ndërroi njehsorin elektrik, dhe pas një kohe njehsori është dërguar në qendrën e kalibrimit dhe është vërejtur se është keqpërdor, ku edhe jam ngarkuar me borxh të madh nga KEK-u, te cilin borxh unë nuk e kam krijuar pasi që njehsorin elektrik e kam gjetur në atë gjendje.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK e datës 22.10.2010
- Me datë 04.11.2010 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalin e inspektimit të kontrollës dhe kalibrimit.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 04.11.2010
- Me datë 11.11.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së, datë 04.11.2010
- Me datë 15.08.2011, DMK ka lëshuar vendimin duke aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të:
 1. Shkarkojë shifrën DPZ08HP04269 nga fatura e rikthimit të humbjeve të datës 30.04.2008 në vlerë prej 3,267.29 €
- Me datë 23.09.2011 KEK-u ka apeluar vendimin e DMK në Bordin e ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit drejtuar Bordit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK_V_633_08_11** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** KEK -un për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK. Bordi i ZRRE-së ka vendosur që vendimi i DMK-së: **ZRRE/DMK_V_618_06_11** të mbetet në fuqi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar